



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 167 Akti

Nr. 185 Vendimi

Tiranë, më 23.7.2019

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare
<b>Olsi Komici</b>	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në Tiranë, në datën 23 korrik 2019, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Olsian Çela**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Olsi Komici, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N :

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Olsian Çela, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 17.9.2018, në përputhje me rregulloren, “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bektoshi dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.09.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Olsian Çela, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 9.7.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Olsian Çela, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 9.7.2019 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

### II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 17.7.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 19.7.2019, ora 10:15, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Olsian Çela, kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Olsian Çela ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Olsian Çela, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit u krye për të tria kriteret: (1) vlerësimin e pasurisë; (2) kontrollin e figurës; dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Olsian Çela, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, më datë 30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

### ❖ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”.

**1. Njësi me sipërfaqe 77.8 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, numër pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, Tiranë, blerë me kontratën<sup>1</sup> e datës 8.4.2015, me vlerë 78,500 euro. Pjesa takuese: 100 %.**

Burimi i krijimit:

- a) Shuma 66,000 euro nga kontrata e kalimit të të drejtave mbi apartamentin te Rr. “\*\*\*\*”, e datës 6.4.2015 me palë z. Olsian Çela dhe palë e dytë znj. S.Ç., (kaluar të drejtat për apartamentin më 30.3.2011, me nr. \*\*\*, (6,800,000 lekë me burim: 2,600,000 lekë kursime personale; 1,800,000 lekë kursime të znj. S.Ç.; 2,400,000 lekë nga të afërmit, nga të cilat janë shlyer 700,000 lekë në vitin 2016 me kursimet e viteve 2014 dhe 2015).
- b) Shuma 640,651 lekë nga llogaria në “Credins Bank”.
- c) Shuma 1,150,000 lekë nga kursimet që disponoheshin *cash*. Burimi i depozitës dhe i parave *cash* të ardhurat personale, si dhe interesat e krijuara nga llogaria bankare.

Komisioni ka kryer korrespondencë<sup>2</sup> me ZQRPP-në Tiranë, dhe ZVRPP-në Tiranë. ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar se në emër të z. Olsian D. Çela rezultoi e regjistruar pasuri

<sup>1</sup> Kontrata nr. \*\*\*, datë 8.4.2015, për njësinë me sipërfaqe 77.8 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”.

<sup>2</sup> Shkresa e ZQRPP-së nr. \*\*\*prot., datë 4.1.2019, drejtuar ZVRPP-ve; shkresa, nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2019, e ZVRPP-së Tiranë, drejtuar Komisionit.

e transkriptuar e llojit “Njësi” me sip. 77 m<sup>2</sup>, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\*, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Për këtë pasuri është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie datë 22.4.2015.

Kjo pasuri është përfituar nga kontrata e shitblerjes<sup>3</sup> e datës 8.4.2015 me palë shitëse P. H., dhe palë blerëse Olsian Çela për çmimin 78,500 euro, shumë e cila është transferuar fillimisht në llogarinë bankare të noterit A.M., dhe më pas në llogarinë bankare të shitësit, vërtetuar kjo edhe nga dokumenti bankar i “BKT”-së së datës 8.4.2015.

ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se këtë pasuri subjekti ia ka shitur me kontratën e shitblerjes<sup>4</sup> datë 24.2.2018 blerësit A.M., me çmimin 85,500 euro, që paguhet nga blerësi në llogarinë bankare të noterit dhe më pas transferohet tek shitësi, vërtetuar ky veprim dhe nga dokumenti bankar i datës 27.2.2018.

Komisioni, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe deklarin e subjektit, i vlerësoi ato të plota dhe të sakta.

## **1.1 Analiza e burimit të krijimit të shumës 78, 500 euro, e përdorur nga subjekti për blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi”**

### **1.1.a Në lidhje me mënyrën e përfitimit të shumës 66,000 euro:**

Subjekti ka përfituar një apartament nëpërmjet kontratës për kalim të drejtash të datës 30.3.2011<sup>5</sup>, me palë të para S., M., dhe M.B (poseduesi) dhe palë të dytë Olsian Çela (përfituesi), si dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (me cilësinë e marrjes dijeni).

Objekt i kësaj kontrate është kalimi i të drejtave që pala e parë ka mbi apartamentin me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Vlera e kësaj kontrate është 6,800,000 lekë, e cila është likuiduar para redaktimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

Me kontratën e kalimit të të drejtave të datës 6.4.2015<sup>6</sup>, me palë të parë Olsian Çela (poseduesi) dhe pala e dytë S.Ç., (përfituesi), bëhet kalimi i të drejtave që pala e parë ka mbi apartamentin me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, kundrejt çmimit 66,000, euro, i cili është likuiduar para redaktimit të kontratës noteriale.

Komisioni, me pyetësorin nr. 4 drejtuar subjektit, ka kërkuar shpjegime në lidhje me:

- arsyen e shitjes së apartamentit nënës së tij kur subjekti jeton bashkë me të dhe kur ajo (e ëma) e kishte financuar në kohën e kalimit të të drejtave të këtij apartamenti në shumën 1,800,000 lekë;
- arsyen e shitjes së këtij apartamenti nënës së tij me çmim më të lartë se ai që e ka blerë (afërsisht shitur 17,500 euro më shtrenjtë); dhe
- burimin e krijimit të përdorur nga nëna e tij për blerjen e kësaj pasurie, duke specifikuar sa ka qenë shuma e përdorur nga llogaritë bankare.

Subjekti, në përgjigje të tij ka deklaruar se: “...doja të kryeja një investim relativisht me interes për të arritur sigurimin e fondeve për blerjen e një apartamenti. Duke qenë se në vitin 2015 m’u paraqit një mundësi investimi në një njësi tregtare në rrugën “\*\*\*\*”, i propozova fillimisht nënës që ta blinim bashkë, duke qenë se ajo dispononte 57,000 eurot e përfituara nga shitja e apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, të depozituara në disa banka dhe një sasi paraje në cash...

...më duhet të shpjegoj natyrën e marrëdhënieve familjare, ç’ka vlerësoj se e tejkalon objektin dhe qëllimin e pyetësorit, por i shërben sqarimit të çdo paqartësie. Veprimi juridik u krye brenda familjes dhe nuk u morën në konsideratë faktorë të tillë si çmimi apo sa fitonte apo humbte secili nga ne, pasi raportet tona familjare janë të ndërtuara mbi bazën e solidaritetit dhe kontributit të përbashkët. Ne jetojmë bashkë dhe unë kam qenë

<sup>3</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 8.4.2015, me shitës P. H dhe blerës Olsian Çela.

<sup>4</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 24.2.2018, me shitës Olsian Çela dhe blerës A.M.

<sup>5</sup> Kontrata e kalimit të të drejtave nr. \*\*\*, datë 30.3.2011.

<sup>6</sup> Kontrata e kalimit të të drejtave nr. \*\*\*, datë 6.4.2015.

*kontribuesi kryesor në mirëqenien e familjes përgjatë këtyre viteve. Për këto arsye, duke qenë se të dy kontribujmë në familje, nuk marrim në konsideratë faktorë të tillë si përfitimi individual, duke qenë se në perceptimin tonë nga veprimet juridike, përfitimet janë të dyanshme dhe këto sjellje janë karakteristika tipike të solidaritetit familjar. Mirëqenia ime është e rëndësishme për nënën time, ashtu si dhe mirëqenia e saj është e rëndësishme për mua... Investimi im në blerjen e njësisë tregtare u ndihmua nga nëna ime përmes financimit të shitjes së apartamentit, ndërkohë që mund të ishte realizuar edhe përmes dhurimit të shumës prej 66,000 euro. Ne vlerësuam si më të përshtatshme këtë formë të kalimit të pasurisë, pasi nëna siguronte një shtëpi të sajën edhe për të ardhmen kur unë mund të shkëputem nga ajo dhe të jetoj diku tjetër.”*

### **Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin dhe deklaratimet e subjektit i vlerësoi ato si të plota dhe bindëse.**

1.1.b Në lidhje me **shumën 640,651 lekë** të deklaruar si burim krijimi, u bë verifikimi i llogarive bankare në “Credins Bank” dhe rezultoi që shuma në fjalë është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në datën 7.4.2015.

Konfirmohet ekzistenca e kësaj llogarie bankare, gjendja e saj monetare, dhe tërheqja nga subjekti në datën 7.4.2015, për rrjedhojë, nga Komisioni nuk vërehet ndonjë problematikë në lidhje me këtë burim financiar.

1.1.c Në lidhje me kursimet **në shumën 1,150,000 lekë** që shërbejnë si burim krijimi për blerjen e “njësisë”, subjekti deklaroi se ato i përkasin kursimeve të viteve të mëparshme, konkretisht vitit 2013 dhe vitit 2014, në një total prej 1,000,000 lekë dhe 150,000 lekë të kursyera nga pagat e vitit 2015.

Referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, kursimet në likuiditete janë në shumën 500,000 lekë *cash*, ndërsa për vitin 2014 subjekti deklaroi kursime në likuiditete (*cash* dhe në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Credins Bank”) shumën prej 500,000 lekë, përkatësisht 318,397 lekë *cash* në banesë, dhe 181,603 lekë në llogarinë e pagës në “Credins Bank”.

Në komunikimin me Komisionin, subjekti ka deklaruar se më 31.12.2013 gjendja *cash* në banesë është 467,207 lekë (diferenca prej 32,793 lekë ndodhet në llogarinë e tij të pagës), ndërsa më 31.12.2014 ka poseduar 318,397 lekë *cash*.

Në lidhje me shumën e kursyer 150,000 lekë për vitin 2015 nga pagat e këtij viti, duket se subjekti ka pasur mundësi financiare, pasi shuma që ka përfituar nga pagat deri më 1.4.2015 (konkretisht 3 paga) është në vlerën 374,336 lekë, pra, më e madhe se shuma 150,000 lekë, me diferencë të konsiderueshme.

Komisioni, pasi verifikoi dokumentacionin, deklaratimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, si dhe deklaratimet e subjektit, i vlerësoi ato si të plota dhe bindëse.

Subjekti, me të ardhurat e tij, justifikon burimin e krijimit të shumës prej 640,651 lekë, si dhe të shumës prej 1,150,000 lekë.

### **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi burimet e krijimit të shumës prej 78,500 euro për blerjen e “njësisë” me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, të paraqitura si më poshtë: (i) shuma 66,000 euro; (ii) shuma 640,651 lekë; (iii) shuma 1,150,000 lekë, duke marrë në konsideratë verifikimin e dokumentacionit përkatës justifikues, deklaratimet periodike vjetore dhe deklaratimet e tjera të subjektit, arriti në përfundimin se nuk konstatohet ndonjë problematikë apo indicie që mund të çojnë në ngritjen e dyshimeve që kanë të bëjnë me vërtetësinë dhe ligjshmërinë e burimit të këtyre shumave.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2015</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>11,214,003</b>
Të ardhura nga paga dhe shpërblimet si prokuror	1,655,206
Të ardhura nga paga si lektor Shkolla e Magjistraturës	101,995
Të ardhura nga interesat (O + S. Ç.)	15,335
Të ardhura nga pensioni i pleqërisë S. Ç.	137,577
Të ardhura nga shitja e apartamentit	9,240,000
Të ardhura nga investimi	63,890
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>1,273,814</b>
Shpenzime jetese sipas shkresës shteruese të ILDKPKI -së	448,552
Shpenzime udhëtimi	125,262
Dhuratë për nipin	700,000
<b>Pasuri</b>	<b>9,060,323</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	-11,169,677
Njësi me sip. 77.8 m <sup>2</sup> në Rr. “***”, Olsian Çela nr. pasurie ***	10,990,000
Kalim të drejtash për një apartament 110 m <sup>2</sup> S. Ç.	9,240,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>879,866</b>

Referuar analizës financiare të vitit 2015 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme që burojnë nga puna e tij, të ardhurat nga interesat e depozitave, të ardhurat nga pensioni i pleqërisë i nënës dhe me kursimet e akumuluar nga vitet e mëparshme, ka pasur mundësi financiare për të përballuar blerjen e njësisë dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë vit, duke rezultuar me një balancë financiare pozitive për vitin 2015 në shumën 879,866 lekë.

## **1.2 Analizë e shumës 66,000 euro, të cilën znj. S.Ç, nëna e subjektit të rivlerësimit, e ka përfituar nga burimi:**

- 57,000 euro nga shitja e apartamentit i ndodhur në Rr. “\*\*\*”, i blerë në vitin 1995 me të ardhura familjare (shitje apartamentit dhe kursime).
- 9,000 euro të ardhura nga kursimet në vite (para të lëna në trashëgim, të ardhura nga puna, të ardhura nga pensionet, llogari e interesa bankare).

1.2.a **Shuma 57,000 euro** është përfituar nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 83.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, sipas kontratës së shitjes së datës 24.9.2014<sup>7</sup>, me shitës znj. S.Ç., dhe blerës z. E.N.

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar pronësinë mbi këtë pasuri në emër të nënës së subjektit, znj. S.Ç., blerë me kontratën e shitblerjes në datën 23.10.1995<sup>8</sup>, me çmimin 2,000,000 lekë, nga shitësit bashkëpronarë P., M., A., dhe L.O.

Apartamenti është rivlerësuar në datën 22.10.2013, në vlerën 5,865,600 lekë, për të cilën është paguar dhe tatimi në burim në vlerën 38,656 lekë, në datën 23.10.2013, në “Credins Bank”.

1.2.b Në lidhje me burimin e krijimit të shumës **9,000 euro**, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë sqarime, i cili ka shpjeguar: “... bazuar në shpjegimet e nënës, shuma në fjalë është disponuar nga nëna në gjendje cash, në formën e kursimeve personale. Burimet janë:

- Paratë që unë i kam dhënë periodikisht nënës sime gjatë viteve për t'i shpenzuar për nevoja të saj apo për kursime, pjesën më të madhe të të cilave ajo për shkak të miradministrimit dhe mënyrës së thjeshtë të jetesës e ka ruajtur në formën e kursimeve.
- Paratë e përfituara nga pensioni familjar dhe i pleqërisë që nga viti 2004 e në vazhdim që janë administruar nga ajo, të cilat i ka kursyer duke qenë se të ardhurat për jetesë siguroheshin nga unë.

<sup>7</sup> Kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 24.9.2014.

<sup>8</sup> Kontrata nr. \*\*\*, e datës 23.10.1995.

- Paratë e tërhequra nga depozitat bankare përgjatë viteve deri para momentit të pagesës për apartamentin në datën 6.4.2015 si p.sh., depozita \*\*\* në “Tirana Bank”, tërhequr në datën 14.6.2012, në shumën 449,879 lekë; shuma prej 169,165 lekësh e tërhequr nga llogaria në “Raiffeisen Investment” në datën 4.3.2015.
- Paratë nga puna në Njësinë Minibashkiake nr. \*\*\* në vitet 2010 –2011, për të cilën ka paraqitur edhe vërtetimin përkatës, në vlerën 312,198 lekë.
- Paratë që ajo i ka përfituar nga puna e saj në sektorin privat, por për të cilat nuk disponon dokumente”.

Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë, i vlerësoi ato në përputhje me deklaratimet e subjektit për sa i përket blerjes së apartamentit në Rr. “\*\*\*”, me vlerë 2,000,000 lekë dhe shitur me vlerë 57,000 euro.

Në lidhje me shumën prej 9,000 euro (ose e konvertuar në vlerën 1,263,330 lekë), Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit në lidhje me krijim e shumës prej 9,000 euro. Konfirmohet tërheqja e depozitës në “Tirana Bank”<sup>9</sup> në datën 6.4.2015, në shumën 457,544 lekë, si dhe tërheqja në datën 4.3.2015 e shumës prej 169,165 lekë në “Raiffeisen Invest”<sup>10</sup>, të cituara më lart nga vetë subjekti i rivlerësimit.

### **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se konfirmohet mënyra e përfitimit të shumës prej 57,000 euro nga nëna e subjektit, znj. S.Ç., në përputhje me dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Tiranë.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit, referuar krijimit të shumës prej 9000 euro, janë të plota dhe bindëse, si dhe në përputhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij.

### **1.3 Analizë e shumës 6,800,000 lekë, me të cilën subjekti Olsian Çela ka përfituar apartamentin e ndodhur në Rr. “\*\*\*”**

Ky apartament është përfituar me kontratën e datës 30.3.2011 me palë të parë S., M., dhe M.B., (poseduesi) dhe palë e dytë Olsian Çela (përfituesi) blerë në vlerën 6,800,000 lekë. Shuma prej 6,800,000 lekë, me të cilën subjekti Olsian Çela ka përfituar këtë apartament, është krijuar nga burimet:

- a) Shuma 2,600,000 lekë kursime personale (përbëhet nga 1,050,000 lekë llogari bankare 1,300,000 *cash* + bankë, 250,000 lekë kursimet e pagave të v.2011);
- b) Shuma 1,800,000 kursime të S.Ç;
- c) Shuma 2,400,000 lekë nga të afërmit nga të cilat janë shlyer 700,000 lekë në vitin 2016 me kursimet e 2014,2015.

1.3.a Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 2,600,000 lekë subjekti ka deklaruar:

- Shuma 1,050,000 lekë në llogarinë bankare të depozitës me nr. \*\*\* në RBAL, në emër të z. Olsian Çela; këtë shumë subjekti e ka tërhequr në datën 24.3.2011;
- Shuma 250,000 lekë të ardhurat nga pagat gjatë vitit 2011, pra të kursyera në periudhën janar – mars 2011;
- Shuma 1,300,000 lekë kursime të deklaruara në vitin 2010; këto kursime sipas deklaratimit të subjektit, një pjesë janë lënë në llogarinë rrjedhëse të pagës, e cila më 31.12.2010 është në vlerën 465,337 lekë, dhe pjesa tjetër *cash* në banesë.

Nga hetimi rezultoi se:

<sup>9</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2019, “Tirana Bank”.

<sup>10</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019, “Raiffeisen Invest”.



- Shuma prej 1,050,000 lekë rezulton të jetë e tërhequr në datën 24.3.2011 nga subjekti i rivlerësimit nga llogaria që ai kishte në “Raiffeisen Bank”. Kjo konfirmohet nga dokumentacioni bankar<sup>11</sup>.
- Shuma prej 250,000 lekë të ardhura nga pagat e kursyera gjatë vitit 2011; konfirmohet llogaria e pagës së subjektit në “Credins Bank”<sup>12</sup> (shuma e përfituar nga pagat për periudhën janar – mars 2011 është në vlerën 430,059 lekë).
- Shuma prej 1,300,000 lekë është deklaruar në vitin 2010 nga subjekti në deklaratën periodike vjetore, përkatësisht në shumat 465,337 lekë si kursime në bankë dhe diferenca prej 834,663 lekë e disponuar *cash*. Kursimet në bankë konfirmohen nga lëvizja e llogarive e “Credins Bank”<sup>13</sup>.

Në lidhje me shumën 465,337 lekë, gjendje në bankë në datën 31.12.2010 (shumë kjo që ka shërbyer si burimi krijimi i shumës 1,300,000 lekë), dhe me shumën 250,000 lekë, të ardhura nga pagat e kursyera që janë deklaruar nga subjekti si burim krijimi, nuk ka rezultuar që subjekti t’i ketë tërhequr këto kursime nga llogaria bankare në një total prej 715,337 lekë.

Nga lëvizja e llogarisë bankare të pagës për periudhën janar – mars 2011 konfirmohen në total tërheqje në shumën 360,000 lekë, pra 355,000 lekë më pak se shuma prej 715,337 lekësh e deklaruar si burim krijimi.

Pra, u konstatua mospërputhje deklarimi, ku sipas deklaramit të subjektit tërheqja nga banka duhej të ishte në shumën 715,337 lekë, ndërsa nga lëvizja e llogarisë rezulton që shuma e tërhequr nga subjekti në total është 360,000 lekë.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Subjekti, pas njoftimit të kësaj problematike, në përgjigjet e tij në pyetësorë dhe në seancën dëgjimore, ka deklaruar: *“Në lidhje me sa më sipër ju sqaroj se për shkaqe neglizhence dhe procedurash burokratike të bankës, nuk ishte e mundur të tërhiqeshin në kohë të shkurtër paratë që kisha në bankë dhe unë e plotësova shumën përmes një sasi të parave që kisha tërhequr deri në atë periudhë përmes rrogës si dhe një sasi parash që m’i dha nëna ime, e cila i dispononte cash në shtëpi siç e shpjegova edhe më sipër (shiko shpjegimet në pyetjet e tjera në lidhje me burimet e tyre).*

*Duke qenë se paratë në fakt unë i kisha gjendje në llogarinë e rrogës dhe tërheqja e shumës nuk u bë për arsyet e sipërpërmendura, ia ktheva nënës gradualisht sasinë në fjalë brenda vitit . ... që nga data 31.3.2011 e deri në datën 31.12.2011, duke iu referuar dokumenteve bankarë të “Credins Bank” mbi lëvizjet në llogari, unë kam tërhequr nga llogaria e rrogës shumën prej 1,103,000 lekë nga të cilat edhe kompensova nënën për paratë që i mora në muajin mars të 2011. Për rrjedhojë vlerësoj se nuk ka mospërputhje të deklaramit”.*

## **Konkluzion**

Komisioni, në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 2,600,000 lekë, pasi verifikoi dokumentacionin bankar dhe deklaramet e subjektit, i vlerësoi ato të plota dhe bindëse. Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin mbështetës, i vlerëson të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me mospërputhjen e konstatuar që ka të bëjë me shumën 355,000 lekë.

**1.3.b Shuma 1,800,000 lekë**, kursime të znj. S.Ç., nëna e subjektit, ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit nga z. Olsian Çela në datën 30.3.2011.

<sup>11</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2019, “Raiffeisen Bank”.

<sup>12</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, “Credins Bank”.

<sup>13</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, “Credins Bank”.

Shuma prej 1,800,000 lekë ka si burim krijimi tërheqjen e datës 29.3.2011 në llogarinë në “Alpha Bank”<sup>14</sup>, llogari ku ka kaluar kthimi i investimit në bono thesari. Investimi në bono thesari është depozituar në datën 29.12.2009 në “First Investment Bank”<sup>15</sup>.

Vetë investimi në bono thesari është krijuar nga tërheqja e datës 7.10.2008 e depozitave në shumat 6,283.17 euro dhe 5,916 euro, përkatësisht nga llogaria dyemërore (S., dhe E. Ç.) në “Raiffeisen Bank”<sup>16</sup> dhe nga llogaria e depozitës e znj. S.Ç., në “Tirana Bank”<sup>17</sup>, si dhe tërheqja e shumës 701,805 lekë në datën 23.12.2009, depozituar në llogarinë dyemërore (S., dhe E.Ç.) në “BKT”<sup>18</sup>.

Komisioni vlerësoi se shuma prej 1,800,000 lekë, e deklaruar nga subjekti si burim krijimi, konfirmohet nga dokumentacioni bankar i sipërcituar që nga krijimi deri në tërheqjen e saj.

Kjo shumë e tërhequr në datën 29.3.2011 është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 si investim në bono thesari nga z. E.Ç., me burim llogari të mëparshme bankare dyemërore të tij dhe të znj. S.Ç.; kursime familjare dhe të ardhura nga puna e tij si laborant dentar.

### Konkluzion

Konfirmohet burimi i krijimit të shumës prej 1,800,000 lekë, nga shuma me prejardhje nga llogari të tjera bankare, kontribuuesi kryesor i të cilave është znj. S.Ç.

1.3.c **Shuma 2,400,000 lekë**, e krijuar nga huat që i janë dhënë subjektit nga të afërm të tij (këto hua janë trajtuar/analizuar më poshtë në këtë vendim).

#### Analiza financiare për vitin 2011

Përshkrimi	2011
<b>Të ardhurat</b>	<b>2,442,128</b>
Të ardhura nga paga dhe shpërblimet si prokuror	2,040,476
Të ardhura nga paga si lektor Shkolla e Magjistraturës	116,100
Të ardhura nga Këshilli i Prokurorisë	36,000
Të ardhura nga interesat (O + S. Ç.)	89,039
Të ardhura nga paga S. Ç.	73,414
Të ardhura nga paga, pensioni familjar, S. Ç.	87,100
<b>Detyrime</b>	<b>2,400,000</b>
Hua Xh. A	900,000
Hua M. R	800,000
Hua A. A	700,000
<b>Shpenzime</b>	<b>570,742</b>
Shpenzime jetese sipas shkresës shteruese të ILDKPKI -së	273,240
Shpenzime udhëtimi	97,502
Shpenzime mobilimi	200,000
<b>Pasuri</b>	<b>3,427,654</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	-3,372,346
Kalim të drejtash për një apartament me sip. 110 m <sup>2</sup> , Olsian Çela	6,800,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>843,733</b>

Referuar analizës financiare të vitit 2011 rezulton se subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e përfituara nga puna e tij, të ardhurat nga interesat e depozitave, të ardhurat nga paga dhe pensioni familjar i nënës së tij, dhe me huat e marra nga të afërmit, si dhe me kursimet e

<sup>14</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2019, “Alpha Bank”.

<sup>15</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 9.4.2019, “Fibank”.

<sup>16</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 7.1.2019, “Raiffeisen Bank”.

<sup>17</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 11.1.2019, “Tirana Bank”.

<sup>18</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 17.1.2019, “BKT”.

akumuluar nga vitet e mëparshme, ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar përfitimin e kalimit të të drejtave të apartamentit dhe kryerjen e shpenzimeve të periudhës, duke rezultuar me një balancë financiare pozitive në shumën **843,733 lekë**.

**2. Tokë arë me sipërfaqe 4712 m<sup>2</sup>, \*\*\*, \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, numër \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*.** Pjesa takuese: 33.3 %. Burimi i krijimit: Trashëgimi nga babai i subjektit, z. D.Ç., regjistruar në vitin 2008 (AMTP në bashkëpronësi me S., dhe E.Ç.

**3. Tokë arë me sip. 2979 m<sup>2</sup>, \*\*\*, \*\*\*, zona kastrale \*\*\*, numër \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*.** Pjesa takuese: 33.3 %. Burimi i krijimit: Trashëgimi nga babai i subjektit, z. D. Ç., regjistruar në vitin 2008 (AMTP në bashkëpronësi me S., dhe E.Ç.

Komisioni ka kryer korrespondencë me ZQRPP-në dhe ZVRPP-në Fier<sup>19</sup>, e cila ka konfirmuar bashkëpronësinë në 1/3 pjesë të S., Olsian dhe E. Ç., si pasojë e çeljes së trashëgimisë ligjore (nga vdekja e babait të subjektit, z. D. Ç.), mbi pasurinë me numër \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, e llojit arë, me sipërfaqe 4712 m<sup>2</sup> dhe pasurinë me numër \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit arë me sipërfaqe 2979 m<sup>2</sup>.

Këto dy pasuri janë përfituar nga shtetasi D. Ç., (babai i subjektit), në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”).

Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e depozituar prej tij dhe me dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Fier.

**4. Hua në shumën 900,000 lekë**, marrë shtetases Xh.A., në vitin 2011 për apartamentin në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Huaja është marrë nga të afërm, pa kontratë me shkrim, pa afat dhe pa interes.

Kjo hua është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2011. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale të datës 4.1.2017<sup>20</sup> me deklaruese znj. Xh.A., motra e nënës së subjektit me shtetësi italiane, e cila ka deklaruar se në muajin mars të vitit 2011 i ka dhënë nipit të saj, z. Olsian Çela një shumë prej 900,000 lekë (konvertuar në euro) hua, pa interes dhe pa kontratë me shkrim. Këtë shumë e ka sjellë vetë në Tiranë dhe burim i këtyre të ardhurave janë kursimet e saj.

Subjekti, në datën 30.4.2019, ka depozituar pranë Komisionit dokumentacionin justifikues ligjor mbi mundësinë financiare të znj. Xh.B., konkretisht:

- kërkesë postës për lëvizje raporte/certifikime;
- librezë të depozitave për llogarinë bankare në monedhën euro për periudhën 8.1.2008 – 26.1.2013, në shumën 87.083.55 euro;
- testament publik i datës 22.3.2002, sipas të cilit shtetasja A.U., emëron trashëgimtaren e saj të vetme znj. Xh.A., duke i lënë të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 83,981.29 euro.

Kjo hua është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2011. Komisioni vëren se nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti në lidhje me mundësitë financiare të shtetases Xh.A., rezulton se ajo zotëron pasuri të paluajtshme, si dhe një llogari depozitë në shumën 83,083.55 euro, llogari kjo me progresion rritës. Por, nga kjo llogari nuk rezulton tërheqje që t’i korrespondojë vlerës së konvertuar në 900,000 lekë.

Subjekti ka shpjeguar: “...burimi i parave që tezza më ka dhënë hua ka qenë shuma e parave të lëna trashëgimi nga A.U., e që ajo i dispononte në banesë... shumën e parave që më ka dhënë hua (ekuivalentin në euro të 900,000 lekëve sipas kursit të kohës) e ka pasur në banesë dhe janë nga paratë e lëna trashëgim nga A.U., ...Shuma totale e parave të lëna

<sup>19</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar ZQRPP-së; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 23.01.2019, drejtuar Komisionit.

<sup>20</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 4.1.2017, e shtetases Xh.A.

*trashëgimi ka qenë 100,000 euro, prej të cilave 53,000 euro kanë qenë në bankë që në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe 47,000 euro kanë qenë në cash në shtëpi. Nga koha e çeljes së trashëgimisë dhe deri në 26.1.2013, ajo ka depozituar vazhdimisht para në llogarinë e saj në bankën "Posta Italiane" nga pjesa tjetër e parave të lëna trashëgimi dhe që i dispononte në shtëpi (47,000 eurot në momentin e çeljes së trashëgimisë), derisa në këtë datë, shumave e parave që ndodhej në bankë me origjinë nga trashëgimia ka arritur në vlerën 87,083.55 euro ...përveç parave të fituara nga trashëgimia apo të ardhurave të bashkëshortit N.Z., (trajtohet me pension invaliditeti që prej vitit 2007), ka qenë nga përkujdesja për shtetasen italiane A.M. C., me të cilën ajo banon në të njëjtin pallat".*

Subjekti, shpjegimet e tij i ka shoqëruar edhe me një deklaratën noteriale<sup>21</sup> të shtetases Xh.A., e cila ka dhënë të njëjtin deklaram me atë të sipërcituar nga subjekti. Po ashtu, subjekti ka paraqitur edhe të dhëna nw lidhje me adreswn e shtetases Xh.A., nw Itali.

Referuar dokumentacionit testament, si dhe në raport me shpjegimet e subjektit, provohet se fillimisht, me çeljen e trashëgimisë, rezultonte vlera 53,000 euro në bankë dhe diferenca prej 47,000 euro cash në shtëpi, çka provon se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë subjektit huan në shumën prej 900,000 lekë.

### **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se deklaramet dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti, vërtetojnë mundësinë financiare të shtetases Xh.B., për dhënien hua subjektit të shumës prej 900,000 lekë dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj.

**5. Hua në shumën 800,000 lekë,** marrë shtetases M.R., në mars të vitit 2011 për apartamentin në Rr. "\*\*\*", Tiranë. Huaja është marrë nga të afërm, pa kontratë me shkrim, pa afat dhe pa interes.

Kjo hua është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2011. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shtetase është motra e nënës së tij dhe ka depozituar në Komision një deklaratë në gjuhën shqipe të datës 24.10.2016, e legalizuar nga Bashkia Athinë ku znj. M.R., deklaron se: *"Në mars të vitit 2011 i dhashë hua kushëririt tim Olsian Çela shumën 5,800.78 euro (800,000 lekë) pa taksë, me datë të hapur kthimi huaje, pa marrëveshje. Burimi i këtyre parave që rezulton nga kursimet e mia personale duke punuar në Greqi ku kam jetuar që nga viti 1997 dhe deri më sot. Së bashku me këtë deklaratë dërgoj dhe të dhënat që provojnë në mënyrë të dokumentuar nga IKA (Instituti i sigurimeve shoqërore) me kontributet e mia dhe siguracionet në vit".*

Në datën 30.4.2019 subjekti ka depozituar në Komision dokumentacionin ligjor që justifikon të ardhurat si familje të shtetases M.R.

Duke iu referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit, sipas formularëve të deklaramit të të ardhurave vjetore për efekt të llogaritjes së tatimeve, rezulton se për periudhën 2007 – 2011 të ardhurat e shtetases M.R., dhe bashkëshortit të saj janë në shumën 83,585.60 euro. Kjo shumë justifikon mundësinë financiare të shtetases M.R., për huan e dhënë në shumën 800,000 lekë.

### **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se deklaramet dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti vërtetojnë mundësinë financiare të shtetases M.R., për dhënien hua subjektit të shumës prej 800.000 lekë dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj.

**6. Hua në shumën 700,000 lekë** marrë shtetasit A.M.A., detyrim i shlyer në gusht të vitit 2016.

Kjo hua është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2011.

---

<sup>21</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 15.7.2019, e shtetases Xh.A.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ky shtetas është djali i motrës së nënës së tij dhe ka depozituar deklaratën e datës 24.10.2016 me deklarues A.A., me banim në Athinë, e legalizuar nga Bashkia, i cili deklaroi se : “Konfirmoj së në muajin mars 2011 i kam dhënë kushëririt tim Olsian Çela, 700,000 lekë hua (5076.68 euro) pa interes, pa afat, pa kontratë me shkrim. Në muajin gusht të vitit 2016 detyrimi prej 700,000 lekësh është shlyer plotësisht nga huamarrësi. Burimi i këtyre parave janë kursimet prej punës time në Greqi nga viti 1998 deri më sot. Kësaj deklarate i bashkëlidh edhe një dokument që pasqyron pagesat e sigurimeve shoqërore në vite në shtetin grek.”

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nga vërtetimi i vënë në dispozicion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore të shtetit grek, rezultoi se për shtetasin A.A., janë paguar sigurime shoqërore për periudhën 2002 – 2011, në shumën 107,101 euro. Kjo shumë justifikon mundësinë financiare të shtetasit A.A., për huan e dhënë në shumën 700,000 lekë.

#### Analiza financiare për vitin 2016

Përshkrimi	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,770,606</b>
Të ardhura nga paga dhe shpërblimet si prokuror	1,610,423
Të ardhura nga paga si lektor Shkolla e Magjistraturës	24,575
Të ardhura nga pensioni i pleqërisë S.Ç.	135,608
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>1,170,184</b>
Shpenzime jetese sipas shkresës shteruese të ILDKPKI-së	470,184
Kthim huaje	700,000
<b>Pasuri</b>	<b>-502,607</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	-502,607
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>1,103,030</b>

Sipas llogaritjeve të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë pasur në dispozicion gjithsej shumën prej 1,770,606 lekë nga pagat dhe pensioni dhe 502,607 lekë nga pakësimi i likuiditeteve, nga të cilat, pas zbritjes së shpenzimeve jetike, si dhe kthimit të huas të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016, rezultoi me balancë financiare pozitive në shumën 1,103,030 lekë.

#### Konkluzion

Komisioni vlerëson se deklaratimet dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti vërtetojnë mundësinë financiare të shtetasit A.A., për dhënien hua subjektit, të shumës prej 800.000 lekësh dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij. Gjithashtu, vërtetohet mundësia financiare e subjektit për kthimin e huas në shumën 800,000 lekë.

**7. Kontratë qiraje financiare (leasing)** <sup>22</sup> me “Credins Bank” në datën 12.11.2013, për automjetin tip “Citroen New DS4” (hequr dorë nga qiraja financiare më 12.11.2013). Vlera: 9,159 euro.

Nga korrespondenca e kryer me DPSHTRR-në<sup>23</sup> rezultoi se pronësia e mjetit tip “Citroen Neë DS4”, me targë AA \*\*\*, ka kaluar nga “Credins Leasing” në emër të z. E.Ç.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2012 subjekti ka deklaruar kontratë qiraje financiare (leasing) me “Credins Bank” për automjet, parapaguar 9159 euro + 185 euro interes i menjëhershëm. Burim krijimi i shumës së parapaguar janë nga llogaritë bankare të deklaruara në vitin 2011 (në shumën 1,000,000 lekë) + interesi + të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2012.

<sup>22</sup> Kontrata e qirasë financiare nr. \*\*\*, datë 12.11.2013.

<sup>23</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2019, e DPSHTRR-së.

Subjekti ka depozituar kontratën e qirasë financiare të datës 9.7.2012 të lidhur me shoqërinë “Credins Leasing” si qiradhënës, dhe z. Olsian Çela si qiramarrës i mjetit tip “Citroen New DS4” me çmim 21,500 euro.

Sipas kontratës, qiramarrësi duhet të paguajë 43 % të çmimit të furnizimit, të barasvlershëm me 9159 euro + interesin e menjëhershëm 185 euro. Vlera e mbetur do të paguhet pas përfundimit të afatit të qirasë dhe pas përmbushjes së detyrimeve financiare, e cila është 12,341 euro.

Në datën 12.11.2013 është lidhur kontrata e shitjes me shitës shoqërinë “Credins Leasing” sh. a. dhe blerës z. E. Ç., dhe dhënës i pëlqimit Olsian Çela. Sipas kësaj kontrate pala shitëse “Credins Leasing”, me pëlqimin e qiramarrësit aktual, z. Olsian Çela, i jep të drejtën e blerjes së mjetit blerësit E.Ç., me vlerën e mbetur të financimit dhe qiramarrësi deklaroi se heq dorë nga të gjitha të drejtat që lindin nga kontrata e qirasë financiare e datës 9.7.2012. Çmimi i shitjes është sa vlera e mbetur e financimit ose 9556.64 euro.

Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me heqjen dorë nga kontrata e qirasë financiare nëse është bërë kompensimi i shumave 9,159 euro dhe 2,805 euro, të paguara për subjektin nga ana e vëllait të tij, duke qenë se ai është dhe blerësi i mjetit dhe ka paguar çmimin e mbetur të kontratës.

Subjekti, në përgjigje të tij ka deklaruar: “...nuk është bërë asnjë pagesë nga vëllai tek mua për kalimin e pronësisë së automjetit. Atij i ka kaluar pronësia mbi mjetin sipas kontratës që ju kam paraqitur, pasi ka shlyer detyrimin ndaj bankës. Unë nuk kam kërkuar asnjë shumë parash prej tij dhe nuk kam marrë asnjë pagesë, fakt ky që vërtetohet përveç se nga kontrata e shitjes ku nuk rezulton që të ketë kaluar asnjë shumë parash nga ai tek mua, edhe nga deklarimet e pasurisë në vitin përkatës, ku nuk rezulton asnjë e ardhur nga ky veprimi juridik. Unë kam hequr dorë nga kontrata e qirasë financiare në raport me bankën dhe ky ka qenë i vetmi veprim juridik që unë kam kryer dhe që ka qenë i mjaftueshëm ligjërish për kalimin e pronësisë...”

#### Analiza financiare për vitet 2012 dhe 2013

Përshkrimi	2012	2013
<b>Të ardhurat</b>	<b>2,178,781</b>	<b>1,889,903</b>
Të ardhura nga paga dhe shpërblimet si prokuror	1,896,294	1,500,231
Të ardhura nga paga si lektor Shkolla e Magjistraturës	108,000	54,000
Të ardhura nga Këshilli i Prokurorisë	18,000	-
Të ardhura nga IOM	13,972	-
Të ardhura nga interesat (O + S. Ç.)	52,421	27,800
Të ardhura nga paga, pensioni familjar/pleqërisë S. Ç.	90,094	97,872
Të ardhura nga qiraja e banesës Rr. “***”, janar – shtator 2013		180,000
Të ardhura nga qiraja e tokës bujqësore në Fier për vitin 2013		30,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit		
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>2,090,642</b>	<b>1,080,405</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	282,048	282,048
Shpenzime udhëtimi	210,279	65,899
Shpenzime për kantatën <i>leasing</i> për interes të menjëhershëm	25,848	-
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	1,457,618	392,802
Shpenzime Kasko, TPL dhe noteriale të detyrueshme	114,850	-
Shpenzime mobilimi	-	300,000
Shpenzime rivlerësimi pasurie	-	39,656
<b>Pasuri</b>	<b>-110,435</b>	<b>513,489</b>
Kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)	-110,435	513,489
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>198,574</b>	<b>296,010</b>

Sipas llogaritjeve të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2012 dhe 2013 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë pasur në dispozicion përkatësisht shumat 2,178,781 lekë për vitin 2012 dhe 1,889,903 lekë për vitin 2013, të ardhura nga pagat,

pensioneri, interesat bankare dhe qiraja, nga të cilat, pas zbritjes së shpenzimeve jetike, shpenzimeve për kontratën *leasing* dhe të tjera të kryera, në vitin 2012 rezultoi me balancë financiare pozitive për shumën 198,574 lekë, dhe në vitin 2013, për shumën 296,010 lekë.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti, deklarimet e tij, dokumentacionin e DPSHTRR-së, si dhe duke marrë për bazë analizën financiare të vitit 2013, i gjen ato të plota dhe bindëse dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë.

**8. Të ardhura nga dietat e marra gjatë trajnimit (*fellowship*) të zhvilluar në Britaninë e Madhe (Bramshill) në periudhën janar 2008 – prill 2008, në vlerë të përafërt 3,400 GBP.**

Komisioni konstatoi se subjekti ka depozituar dokumentacionin justifikues në lidhje me bursën e përfituar prej 3,400 GBP, për pjesëmarrjen në kursin “\*\*\*\*” për periudhën 12.1.2008 – 5.4.2008, dhe nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram.

**9. Të ardhura nga qiraja e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*”,** periudha janar – shtator 2013 (subjekti nuk disponon dokumente, marrëveshje me gojë), në shumën 180,000 lekë.

Komisioni ka konstatuar se tatimi në burim për qiranë është paguar në datën 17.3.2017, pas dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI dhe, pavarësisht kësaj, bëhet fjalë për një shumë monetare me një ndikim të papërfillshëm në analizën financiare të vitit 2013.

**10. Të ardhura nga qiraja e tokës bujqësore në Fier,** viti 2013 (subjekti nuk disponon dokumente justifikuese, marrëveshje me gojë) në shumën 30,000 lekë.

Komisioni ka konstatuar se tatimi në burim për qiranë është paguar në datën 17.3.2017, pas dorëzimit nga subjekti të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI dhe, pavarësisht kësaj, bëhet fjalë për një shumë monetare me një ndikim të papërfillshëm në analizën financiare të vitit 2013.

## **11. Të ardhurat e znj. S.Ç., nëna e subjektit**

**11.1 Kursime *cash* në shumën 100,000 lekë,** nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë në vitin 2016. Pjesa takuese: 100 %.

Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë deklaram. Nëna e subjektit ka pasur mundësi financiare për mbledhjen e këtyre kursimeve.

**11.2 Shuma 2,000,000 lekë,** trashëgimi nga bashkëshorti, z. D.Ç., në shkurt të vitit 1998. (Kontratë depozite me “BKT”-në në vitin 1997, një pjesë janë depozituar në Bankën e Kursimeve në vitet 1998 – 1999, mandatarkëtime në vite të ruajtura kryesisht në banka, pasqyra llogarish për depozitat pas vitit 2005).

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me destinacionin dhe përdorimin e kësaj shume

Subjekti, në përgjigjen e tij, ka deklaruar: “... nga shpjegimet e nënës në lidhje me këto depozita sqaroh se shumet në fjalë ndër vite kryesisht janë depozituar në banka të ndryshme ku edhe janë përfituar interesa bankare përgjatë viteve 1997 – 2005 dhe 2006 (interesa të cilat nuk është e mundur të përlllogariten për shkak të mungesës së informacionit, por duhet theksuar se kjo periudhë është karakterizuar nga norma mjaft të larta interesi të depozitave në lek apo valutë). Këto shuma shfaqen në vijim në formën e depozitave tek të dhënat bankare të përftuara në formë elektronike si në rastin e “Raiffeisen Bank” që përmendet edhe në një nga pyetjet tuaja apo dhe në rastin e ‘Tirana Bank’...”

Komisioni i ka kërkuar informacion “Raiffeisen Bank”, e cila në përgjigjen e saj<sup>24</sup> të datës 10.6.2019 ka vënë në dispozicion “inventarë depozita kursimi” për depozitat me nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*.

<sup>24</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2019, e “Raiffeisen Bank”.

Komisioni vlerësoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank” dhe nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri të nënës së subjektit.

**11.3 Dëmshpërblimi në shumën 1,000,000 lekë,** për aksidentin me pasojë vdekjen e bashkëshortit, z. D.Ç., në vitin 1998, paguar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.

Komisioni ka konstatuar se nga korrespondenca e kryer nga ILDKPKI-ja, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.12.2016, ka konfirmuar se nuk rezultojnë të dhëna dokumentare për praktikën e dëmit shëndetësor të aksidentit të datës 19.2.1998 për shtetasin D.Ç., i datëlindjes 13.2.1948, pasi afati ligjor i ruajtjes së dokumenteve kishte përfunduar në vitin 2013.

Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit, i ka kërkuar subjektit shpjegime më të detajuara, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues në lidhje me pagesën e dëmshpërblimit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Në datën 19.2.1998, rreth orës 15:00, në rrugën “\*\*\*” në Tiranë ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti, babai im, D.Ç ... Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* për veprat penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “largimit nga vendi i aksidentit” ndaj shtetasit A.Z., i cili nga hetimi rezultoi të ishte fajtor për aksidentin....Mbi bazën e dekretit nr. 295, datë 15.9.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, që garanton pagesën e një dëmshpërblimi për të dëmtuarin në rastin e dëmeve shëndetësore të shkaktuara nga mjetet motorike, është kryer nga “\*\*\*\*” pagesa në vlerën prej 1,000,000 lekësh. Në lidhje me sa më sipër, duke qenë se kishin kaluar më tepër se 18 vjet nga aksidenti dhe nga nëna nuk ishte ruajtur asnjë dokument për sa më sipër pasi nuk kishte një detyrim ligjor për ruajtjen, nga ana e nënës iu kërkua “\*\*\*\*”-ut praktika e dëmit shëndetësor për rastin në fjalë (dokumentacioni përkatës). Sipas përgjigjes së “\*\*\*\*”, me nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2016, të cilën juve e dispononi, afati ligjor i ruajtjes së dokumentacionit ka përfunduar në vitin 2013 dhe ata nuk dispononin në arkivë të dhëna për praktikën e dëmit shëndetësor. Në këto kushte, vlerësoj se jemi në kushtet e parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016 ku parashikohet se: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit...””*

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit praktikën e aksidentit të të atit dhe konkretisht, fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 1998 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti, në vijim, ka deklaruar: *“Dokumentacioni që po ju vë në dispozicion në lidhje me aksidentin, si dhe legjislacioni në fuqi në kohën e ngjarjes, provon faktin e aksidentit dhe rrethanat ligjore që legjitimonin të drejtën për dëmshpërblim... Për sa më sipër, i kërkoj institucionit të rivlerësimit ta trajtojë sa më sipër në kushtet e parashikuara në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Pamundësia e sigurimit të dokumentacionit është objektive ndërkohë që rrethanat e ngjarjes dhe parashikimet ligjore në lidhje me dëmshpërblimin në rastin e humbjes së jetës nga aksidentet provojnë përfitimin e tij.”*

### **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi përgjigjen e vënë në dispozicion nga shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*” sh.a., deklarimet e subjektit mbi ngjarjen, si dhe fashikullin penal nr. \*\*\* të vitit 1998 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie dhe vlerëson si të vërteta deklarimet e tij lidhur me përfitimin e shumës prej 1,000,000 lekë në vitin 1998, paguar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.



**11.4 Të ardhura në shumën 1,248,010 lekë**, nga pensioni për vdekjen e bashkëshortit dhe pensioni i pjesshëm i pleqërisë për periudhën shkurt 1998 – tetor 2016

Subjekti ka depozituar në Komision vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2019, lëshuar nga ISSH-ja për periudhën 20.2.1998 – 30.6.2019, që vërteton se për të gjithë këtë periudhë, znj. S.Ç., ka përfituar shumën 1,533,234 lekë, ku përfshihet dhe shuma e deklaruar nga subjekti në vlerën 1,248,810 lekë.

### **Konkluzion**

Komisioni vlerësoi se përputhet deklarimi i subjektit me vërtetimin e ISSH-së në lidhje me shumën e përfituar nga pensioni.

## **12. Konstatime të tjera**

### **12.1 Në lidhje me të ardhurat e znj. S.Ç., nëna e subjektit të rivlerësimit**

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me deklaratimet periodike për nënën e tij, znj. S.Ç., për periudhën 2003 – 2016, për shkak se ai nuk ka deklaruar nëse ka qenë në marrëdhënie pune dhe, në këtë rast sa kanë qenë të ardhurat nga punësimi, apo nëse ka qenë në pension pleqërie.

Subjekti, në përgjigjen e tij, ka deklaruar: *“Deklarimet nuk janë bërë pasi në formularin e deklaratimit deklaroheshin vetëm të ardhurat e bashkëshortes ose të fëmijëve dhe nuk kam pasur detyrimin të deklaroja të ardhurat e pjesëtarëve të tjerë të familjes. Deri në formularin e fundit që kam dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2018, në asnjë rast unë nuk kam deklaruar të ardhurat apo kursimet e nënës sime, duke qenë se nuk është detyrim ligjor, pasi nga formularët që plotësojmë, ajo nuk konsiderohet person i lidhur. Siç duket qartë edhe nga formularët e kohës, por edhe ata aktualë, detyrimin e deklaratimit dhe i plotësimit e kishin dhe e kanë vetëm bashkëshortët apo fëmijët. Disa nga kursimet e saj në depozita bankare unë i kam deklaruar vetëm në vitet 2008 dhe 2009, dhe kjo është bërë gabimisht, për shkak të paqartësive për plotësimin e formularit, pasi nuk kisha detyrim për deklaratim. Nisur nga çfarë ata më kanë thënë në atë kohë dhe tani, nëna dhe vëllai në disa raste kanë kryer depozitime të kursimeve të tyre bashkë, për efekt të lehtësive që lidhen me veprimet bankare. Në vitin 2009, një pjesë e kursimeve që dispononte nëna dhe vëllai janë depozituar në formën e bonove të thesarit, në “First Investment Bank”, në emër të vëllait, pasi kështu është rënë dakord mes tyre. Nga shumë e përgjithshme e investuar në bono thesari, sipas shpjegimeve që më kanë dhënë vëllai dhe nëna, vëllait i përkisnin 50.000 lekë, shumë e cila i është kthyer nga nëna në momentin e tërheqjes. Ai është informacion që unë e kam marrë gojarisht nga nëna dhe vëllai, pasi i kam pyetur për efekte të deklaratimit. Në lidhje me të ardhurat e nënës sime ndër vite, ju kam dorëzuar dokumentet që ajo ka për kohën e punësimit, të ardhurat e pensionit të pleqërisë, si dhe të ardhurat që ka përfituar nga pensioni familjar i marrë pas vdekjes së babait tim ndër vite si e ve, sipas dokumentacionit bashkëlidhur. Për sa më sipër kam dorëzuar bashkë me formularin e deklaratimit<sup>25</sup>.”*

<sup>25</sup> Vërtetim nga njësia administrative nr. \*\*\* ku znj. S.Ç., ka qenë e punësuar, për të ardhurat në vitet 2010-2011, në vlerën neto 312,198 lekë.

Vërtetim nga DRSSH-ja, datë 21.10.2016, për trajtimin me pension familjar dhe me pension pleqërie deri në datën 31.10.2016 në vlerën 1 248 010 lekë.

a. Tri mandate arkëtimi të shumave respektive 1,000,000; 800,000 dhe 150,000 lekë të “Bankës së Kursimeve”, para të lëna trashëgimi nga babai i subjektit, z. D.Ç.

b. Për shumën 1,000,000 lekë të paguara nga “\*\*\*\*”-u për aksidentin ku humbi jetën babai i subjektit, përgjigje e institucionit, datë 19.12.2016, i cili nuk e ka ruajtur dokumentacionin e atyre viteve, pasi afati ligjor për ruajtjen ka qenë deri në vitin 2013.

c. Pasqyra të llogarive bankare nga bankat “Raiffeisen Bank”, “BKT” dhe “Banka e Tiranës” përgjatë viteve, ku znj. S.Ç., ka përfituar edhe interesa sipas pasqyrave përkatëse.

ç. Në lidhje me vitet 1998 – 2007, ku ajo ka kryer punë të ndryshme në sektorin privat dhe ka deklaruar shumën e përafërt 900,000 lekë, por nuk disponon dokumente.

*Këto shuma, sipas asaj që ajo më ka pohuar, i ka kursyer në gjendje cash apo edhe i ka depozituar pjesërisht, në periudha të ndryshme.”*

### **Konkluzion**

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me të ardhurat e nënës së tij, znj. S.Ç.

#### 12.2 Në lidhje me **kursimet cash** të znj. S.Ç.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me destinacionin e përdorimit të depozitave dhe shumave të tërhequra.

Subjekti, në përgjigjet e tij ka deklaruar: *“... disa nga këto depozita janë tërhequr dhe janë mbajtur nga S.Ç., në formën e kursimeve cash”*[...] *“... rregullisht një pjesë të parave të marra nga puna si prokuror, në mënyrë periodike, ia kam dhënë për administrim nënës, në mënyrë që ajo të shpenzonte sa duhej për nevojat e familjes apo edhe të kursente përmes menaxhimit të tyre”* [...]

Pra, pavarësisht se ajo ka të ardhurat e saj nga pensioni familjar, ai i pleqërisë, të ardhura nga pagat etj. subjekti deklaroi se i ka dhënë periodikisht para nga paga në mënyrë që ajo t'i ruajë si kursime të vetat.

Subjekti është pyetur në lidhje me destinacionin e shumës prej 700.000 lekë që ka tërhequr në datën 24.12.2009 nga llogaria e tij e pagës dhe ai deklaroi: *“Paratë ia kam dhënë nënës, e cila ka shumë mundësi që një pjesë të vogël të shumës në fjalë ta ketë përdorur për shpenzime personale apo familjare, ndërkohë që pjesën më të madhe e ka ruajtur, duke ia bashkuar kursimeve të tjera të saj”*.

### **Konkluzion**

Komisioni vlerësoi se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me destinacionin e depozitave të tërhequra, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për kursimet e nënës tij.

#### 12.3 Në lidhje me **të ardhurat** e z. E.Ç., vëllai i subjektit

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e të ardhurave të vëllait, E. Ç., për periudhën 2003 – 2010.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij, ka deklaruar: *“Vëllai gjatë atyre viteve ka qenë i punësuar në sektorin privat dhe nuk disponon dokumente justifikuese. Nisur nga sa ai më ka dhënë informacion, deri në vitin 2010 kur ka qenë ende i përfshirë në certifikatën familjare, ka punuar për disa vjet në një laborator dentar të një shtetasi turk, si dhe në një firmë produktesh dentare. Në lidhje me depozitat bankare në emër të tij dhe të nënës, ato unë i kam deklaruar vetëm për vitin 2008 dhe 2009, dhe kjo është bërë gabimisht për shkak të paqartësive në plotësimin e formularit, pasi nuk kisha detyrim për deklarim as ato vite, pasi sipas formularëve të deklarimit ai nuk konsiderohej person i lidhur...”*.

Subjektit ka dhënë shpjegime në lidhje me vendbanimit e vëllait të tij, z. E.Ç., pas shkëputjes nga familja duke deklaruar: *“Nisur nga informacioni që më ka vënë në*

---

d. Ndërkohë përgjatë gjithë viteve të punës, subjekti deklaroi se për çdo muaj, i ka dhënë nënës së vet vazhdimisht para nga të ardhurat e tij, me qëllim që ajo të kishte kursimet e veta personale e t'i përdorte për qëllimet e saj.

Në llogaritjen e të ardhurave të saj, mungon shuma e interesave bankare mbi shumat e depozituar nga ajo në banka, në periudhën 1998-2005, për shkak të mungesës së ruajtjes së dokumentacionit nga ana e bankave Për llogaritjen e interesave bankare për vitet 1998-2005, Raiffeisen Bank, në përgjigjen e datës 26.10.2016, ka shpjeguar se nuk disponon të dhëna të plota rre ruajtura në formë elektronike. Banka nuk disponon as kopje të kontratave të depozitave për periudhën 1998-2005.

*dispozicion vëllai, deri në momentin e shkëputjes përfundimtare në vitin 2010, pra, mes viteve 2008 – 2010, ai ka jetuar në një apartament të vjehrrit të tij aktual, S.B., i ati i S. Ç., (B), në një apartament në pronësi të këtij të fundit, i përfutuar si pronar i tokës ku është ndërtuar pallati, në zonën “\*\*\*”. Ai nuk i ka paguar qira këtij personi, për shkak të marrëdhënieve që kishin.”*

## **Konkluzion**

Komisioni i analizoi shpjegimet e subjektit dhe vlerësoi se ai e ka sqaruar mjaftueshëm situatën në lidhje me punësimin dhe me banimin e të vëllait, z. E.Ç., pavarësisht se nuk rezultoi që mes tyre të ekzistojë ndonjë interes pasuror që mund ta kualifikojë atë si person tjetër të lidhur, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, apo të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

### **12.4 Në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të z. E.Ç., vëllai i subjektit**

Subjekti, në deklaratimet e tij, ka sqaruar: *“Vëllai im, E.Ç., është shkëputur nga familja në moshën 27-vjeçare në vitin 2008 dhe zyrtarisht nga trangu familjar në vitin 2010. Prej këtij viti, ai nuk ka përfutuar prej tij dhurime, pasuri apo të ardhura të tjera, si dhe nuk ka marrë apo dhënë hua, marrëdhënie këto prej të cilave të lindin detyrime për mua apo për atë, për të dhënë shpjegime në bazë të parashikimeve të pg.4, të nenit 32, të ligjit nr.84/2016, ku parashikhet: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.*”

Pavarësisht këtij fakti, Komisioni ka kryer hetime në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe për llogarit bankare në emër të të vëllait të subjektit. Komisioni ka kryer korrespondencë me ASHK-në, DSHPRRT-në<sup>26</sup>.

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Drejtoria Vendore Fier, ka konfirmuar pasuritë e llojit *arë*, përkatësisht me sip. 4712 m<sup>2</sup> dhe 2979 m<sup>2</sup> në \*\*\*, \*\*\*, në emër të z. E.Ç., në bashkëpronësi me znj. S., dhe z. Olsian Çela.

ASHK-ja (Drejtoria Vendore Tiranë) ka konfirmuar se në emër të z. E.Ç., ka qenë e regjistruar pasuria e llojit *garazh* me sipërfaqe 18.5 m<sup>2</sup> dhe 13.65 m<sup>2</sup> të blera në vitin 2012, kur ai ka qenë i shkëputur nga familja e tij e origjinës, të cilat janë tjetërsuar më pas.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me burimin e krijimit dhe me mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive nga vëllai i tij.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për sa ai është pyetur nga Komisioni duke sqaruar situatën e të vëllait të tij, z. E.Ç.

- DPSHTRR-ja ka konfirmuar se në emër të z. E.Ç., kanë rezultuar në pronësi disa mjete, të cilat i ka tjetërsuar më pas, konkretisht: automjetin tip “Golf” me targë AA \*\*\*, të cilin më pas e ka tjetërsuar, si dhe automjetin tip “Renault Laguna” me targë AA \*\*\*. Këta automjete rezultojnë të blerë përkatësisht në vitet 2012 dhe 2014, kur ai ka qenë i shkëputur nga familja e tij e origjinës.

Për dy automjetet e sipërcituara subjekti është pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e krijimit të tyre. Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me burimin e krijimit të këtyre mjeteve nga vëllai i tij.

## **Konkluzion**

<sup>26</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2019, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Fier; Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 20.05.2019, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë; Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 16.4.2019, e DPSHTRR-së.

Komisioni vlerëson se në lidhje me vëllanë e subjektit, z. E.Ç., subjekti nuk ndodhet në kushtet e pikave 14, 32 dhe 4, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nga hetimi nuk rezultoi se subjekti ka përfutuar prej tij dhurime, pasuri apo të ardhura të tjera, nuk ka marrë apo ka dhënë hua, si dhe nuk ekziston ndonjë marrëdhënie biznesi apo pasurore prej të cilave të rezultojë një interes i përbashkët, marrëdhënie këto prej të cilave të lindin detyrime për subjektin apo dhe për të vëllanë për të dhënë shpjegime në bazë të parashikimeve të dispozitës së cituar më sipër. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me vëllanë e tij është i plotë dhe i saktë.

12.5 Në lidhje me të **ardhurat** në shumën 300,000 lekë, të përfutuar nga shitja e automjetit në shtator të vitit 2003, që kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e mjetit me targë TR \*\*\*.

Komisioni ka kryer korrespondencë me DPSHTRR-në<sup>27</sup>. Subjekti, në deklaratën e vitit 2003, ka deklaruar blerjen e mjetit me targë TR \*\*\*, në shumën 300,000 lekë, me burim krijimi “blerë me të ardhurat e marra nga shitja e një mjeti tjetër “Daimler Benz” në vitin 2003 (në shtator)”.

DPSHTRR-ja ka sjellë informacion lidhur me automjetet që ka pasur më parë në pronësi subjekti, por nuk konfirmon pronësinë e mjetit “Daimler Benz” apo të tjetërsuara deri në datën 31.12.2003.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë kontratën e blerjes dhe atë të shitjes “deklaruar shitur në shtator 2003” të automjetit.

Subjekti, në përgjigjet e tij, ka deklaruar: *“Këtë kontratë nuk e disponoj, për shkak të periudhës së gjatë që ka kaluar. Ajo që kujtoj është se automjeti është blerë rreth fundit të viteve '90, por nuk arrij të kujtoj detaje të tjera”. Në lidhje me këtë kontratë, bëra kërkimet e mia në DRSHTRR-në Tiranë, por nuk u bë e mundur gjetja e saj vetëm mbi bazën e të dhënave që unë disponoja. Edhe nga kërkimet që KPK-ja ka kryer për mjetet në pronësinë time ndër vite (i referohem dosjes së hetimit administrativ që më është vënë në dispozicion në datën 11.7.2019), rezultoi se për këtë automjet (automjeti me targa TR \*\*\*) kjo drejtori nuk disponon asnjë të dhënë... për të cilin ju kam vënë në dispozicion kontratat e blerjes dhe shitjes... Duke qenë se objekt i pyetjes është një automjet i blerë në fund të viteve '90 dhe i shitur në vitin 2003, mund të konkludohet qartësisht se mungesa e informacionit vjen për shkak të problemeve teknike në hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik të DQSHTRR-së. Në këto kushte, vlerësoj se jemi në kushtet e parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, që parashikon pamundësinë objektive të sigurimit të dokumentit... Megjithatë, përtej këtij fakti, duke iu referuar konstatimit tuaj mbi balancën negative në vitin 2003, vlerësoj se nisur edhe nga analiza financiare e vitit në fjalë, duke shtuar këtu edhe sasitë e parave që dispononte familja ndër vite, interesat bankarë, të ardhurat e mia nga puna në vitet paraardhëse, në raport edhe me shpenzimet mesatare për jetesë të asaj periudhe të përllogaritura nga ju, pavarësisht burimit të shumës së përdorur për blerjen e mjetit në vitin 2003, unë kam pasur të gjitha mundësitë financiare për të mbuluar këtë shpenzim brenda vitit 2003 edhe nëse do të më mungonte ky burim.”*

Në vlerësim të situatës që rezultoi nga hetimi i Komisionit, i cili vlerësoi shpjegimet e subjektit, në vlerësim edhe të informacioneve të marra nga DPSHTRR-ja (e cila verifikoi të dhënat në regjistrin elektronik), vërehet se as subjekti dhe as institucioni përgjegjës nuk administrojnë të dhëna për këtë pasuri. Po ashtu, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me një fakt të deklaruar nga ai se edhe për një automjet të blerë në vitin 2003 institucioni përgjegjës nuk ka dërguar të dhëna dhe se të dhënat para viteve 2003 hidheshin në mënyrë manuale dhe kjo ka sjellë edhe këtë pasojë të mospasqyrimin të të gjitha të dhënave për ato periudha.

<sup>27</sup> Shkresa nr \*\*\* prot., datë 3.1.2019 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2019 të DPSHTRR-së.

Edhe nëse nuk e marrim në konsideratë këtë shumë në analizën financiare për vitin 2003, situata financiare për vitin 2003 nuk mund të vlerësohet si situatë negative pasi kjo analizë përfshin vetëm të ardhurat e atij viti dhe nuk vjen në kronologji të të ardhurave dhe kursimeve ndër vite.

Po ashtu, analiza financiare për vitin 2003 përfshin edhe vlerën e depozituar në “Tirana Bank” nga nëna e subjektit në shumën 600,000 lekë, për të cilën subjekti ka dhënë shpjegime se ajo e ka burimin nga depozita të krijuara më herët ndër vite nga nëna e tij, duke përjashtuar kështu mundësinë krijimit të kësaj depozite nga të ardhurat e vitit 2003. Ekzistenca e depozitave në emër të nënës së subjektit u dokumentua edhe nga bankat përkatëse. Në këto kushte efekti financiar për vitin 2003 nuk del me situatë financiare negative.

Komisioni kreu analizën financiare në kuadër të verifikimit të aftësive financiare bazuar në dokumentacionin zyrtar të ardhur nga institucionet përkatëse për vitin 2003, pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

#### Analiza financiare për vitin 2003

Përshkrimi	Të ardhurat	Shpenzime	Pasuri	Rezultati financiar
Subjekti i rivlerësimit	637,461	281,592	300,000	55,869
Nëna e subjektit	0	0	600,000	-600,000
Total	637,461	281,592	900,000	-544,131

Sipas llogaritjeve të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin 2003 subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë pasur në dispozicion gjithsej shumën prej 637,461 lekë, nga të cilat, pas zbritjes së shpenzimeve jetike, blerjes së një automjeti në shumën 300,000 lekë, si dhe depozitës së krijuar nga nëna e tij në shumën prej 600,000 lekësh, rezultoi me një balancë negative në shumën – 544,131 lekë, por referuar argumenteve të mësipërme dhe dokumentacionit të administruar se shuma prej 600,000 lekësh nuk është e krijuar nga të ardhurat e vitit 2003, por vjen e mbartur nga depozitat e viteve të mëparshme, situata financiare për vitin 2003 rezulton me balancë pozitive në shumën + 55,869 lekë.

#### Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Ai ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e neneve 4, pika 4, 37 e 38, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision<sup>28</sup> raportin përfundimtar, ku rezulton se:

- formulari i deklaramit është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;

<sup>28</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2019, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
- për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

*Në përfundim të raportit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Olsian Çela është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

Gjatë procesit të hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Olsian Çela.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Olsian Çela ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe është miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2019 për subjektin **Olsian Çela**.

Në këtë raport të miratuar dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë evidentuar aftësi të mira të subjektit të rivlerësimit në lidhje me: a) aftësitë organizative; b) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale dhe c) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Nga vlerësimi i akteve të përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Komisioni ka shqyrtuar tri dosjet e zgjedhura nga vetë subjekti dhe pesë dosjet e shortuara nga Komisioni, si dhe të dhëna nga burimet arkivore dhe të strukturave të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme.

#### **➤ Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

Referuar raportit të përcjellë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në të tria dokumentet e zgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit nuk konstatohen veprime të subjektit në shkelje me ligjin apo me procedurën.

#### **➤ Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short**

Referuar raportit të përcjellë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në të pesta dokumentet e hedhura me short nuk janë konstatuar veprime të subjektit në shkelje me ligjin dhe me procedurën.

Në lidhje me dokumentin “dosja \*\*\*”, ku nga ana e subjektit, z. Olsian Çela, në cilësinë e prokurorit të kësaj çështjeje është marrë vendimi “për mosfillim të procedimit penal, i datës 11.3.2014, për kallëzimin nr. \*\*\* të datës 28.2.2014”, Komisioni vlerësoi të arsyeshme që të kërkonte nga subjekti shpjegime mbi këtë vendimmarrje.

Komisioni, pasi i dërgoi rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me marrjen e këtij vendimin për mosfillim dhe konkretisht lidhur me pamjaftueshmërinë e

indiceve të cilat mund të zhvilloheshin apo të tkurrëshin ose eliminoheshin përgjatë një hetimi të thellë dhe gjithëpërfshirës, i cili do të mund të qartësonte çdo dyshim të ngritur.

Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, ka shpjeguar: “...në referimin e policisë për çështjen në fjalë, mungojnë të dhëna të rëndësishme që lidhen me faktin konkret, përfshirjen e subjektit, kohën e kryerjes, gjendjen e procedimit, provat që e lidhin subjektin me faktet penale etj., të cilat janë shumë të rëndësishme në lidhje me besueshmërinë e regjistrimit të procedimit pasuror dhe aplikimin e masave ndaj pasurisë dhe e vetmja e dhënë që policia dispononte ishte se ndaj këtij personi po kryheshin hetime nga autoritetet e huaja...”

[...]

Në kushtet e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja për fakte të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë e për të cilat nuk ka një procedim të regjistruar, ngelet që cilësimin juridik të faktit penal mund ta bëjë vetëm gjykata, si organi kompetent që vendos në lidhje me ekzekutimin e letërporosive apo njohjen e vendimeve penale të huaja.

Në rastin në fjalë të dhënat disponoheshin nga autoritetet italiane që kanë qenë duke kryer një hetim ndaj një shtetasi shqiptar. Dijenja e policisë shqiptare mbi një hetim të tillë nuk mund të përbëjë të dhënë provuese me karakter indiciar në kuptim të ligjit për veprën penale konkrete për të gjitha arsyet e parashtruara më lart.

[...]

Autoritetet e huaja kanë kërkuar vetëm identifikimin e plotë të një shtetasi shqiptar dhe nuk kanë paraqitur të dhëna të tjera në lidhje me faktet që hetonin apo prova në lidhje me to. Ka qenë në vullnetin e tyre të përcaktojnë nivelin e bashkëpunimit në rastin konkret, duke vlerësuar nevojat e tyre të hetimit.

[...]

Policia shqiptare ka gabuar në mënyrën si e ka trajtuar kërkesën për informacion, pa marrë në konsideratë nevojat e autoritetit të huaj për ruajtjen e sekretit hetimor, duke ia ekspozuar të dhënat një procesi administrativo-civil... dhe ekspozimi i fakteve përbën rrezik të lartë për dekonspirimin e hetimeve.

Në përfundim të sa më sipër vlerësoj se trajtimi i rastit është bërë në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, dhe udhëzimit nr.106, të datës 18.5.2010, të Prokurorit të Përgjithshëm, në zbatim të tij. Vendimi i mosfillimit në rastin konkret nuk pengon që në një moment të dytë, nëse do të përmbushen kërkesat e ligjit, të kryhet një hetim pasuror ndaj subjektit dhe të aplikohen masat ndaj pasurisë.

#### ❖ Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit në lidhje me vlerësimin prej tij të të dhënave që janë referuar në këtë çështje është i drejtë dhe ligjor, në konsideratë të natyrës dhe të tipologjisë që ka hetimi pasuror në kuptim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, të trafikimit dhe të korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Për pasojë, Komisioni nuk konstaton problematika ligjore në drejtim të marrjes prej tij të vendimit për mosfillimin e procedimit në fjalë.

➤ **Procedimin penal nr. \*\*\* i vitit 2006.** Dosja e këtij procedimi është administruar më herët nga Komisioni për shkak të verifikimeve të kryera gjatë procesit të rivlerësimit për një tjetër subjekt rivlerësimi dhe është administruar praktika e plotë e këtij procedimi nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër<sup>29</sup>. Nga kjo praktikë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, së bashku me një prokuror tjetër, kanë qenë dy prokurorët e kësaj

<sup>29</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2019, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila ka të bashkangjitur 7 fashikuj.

çështjeje për të cilën janë marrë dy vendime: (1) vendimi i datës 19.3.2007, “Pushim i hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* i vitit 2006”, në ngarkim të personave nën hetim A. M., P. G., A. Xh., G. S., K. E., A. T., D. G., dhe P. B., për mungesë provash; (2) vendimi i datës 29.6.2007, për “shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve” të datës 29.6.2007 për shtetasit V. Gj., dhe H. M.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e ndodhur në shtatë fashikujt, të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, vlerësoi të nevojshme t'i kërkojë subjektit shpjegime në lidhje me veprimet e kryera për hetimin e kësaj çështjeje, duke ngritur dyshime se hetimet në fjalë që janë konkluduar me vendim pushimi, duhet të konsistojnë në: vlerësimin si elemente me interes për hetimin e përgjimeve të shtetasit P. B.; marrjen në pyetje e shtetasit P. B. në lidhje me materialet e sekuestruara në banesën e tij, shkaku e ndërprerjes së operacionit të vëzhgimit i datës 14.06.2007; marrjen në konsideratë të vëzhgimeve, përgjimeve, administrimit dhe vlerësimin e provave, pyetjen e personave etj., dukej se nuk kishin qenë të plota dhe gjithëpërfshirëse nga ana e prokurorisë.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij të dërguara pas rezultateve të hetimit, si dhe ato të dhëna në seancën dëgjimore, ka argumentuar: “Hetimet e natyrës proaktive janë mjaft komplekse dhe kërkojnë angazhimin e mjaft burimeve njerëzore, financiare e teknike mes strukturave të hetimit, me qëllim finalizimin me sukses të tyre, të cilat mundësojnë grumbullimin e elementeve provuese në drejtim të veprës penale dhe autorëve të saj. Në rastin e hetimit të procedimit nr. \*\*\* mungoi ky angazhim i strukturave të policisë.

[...]

Ndryshe nga një hetim i zakonshëm, suksesi i këtij hetimi varej nga veprimet në terren të policisë, në aftësinë e tyre për të identifikuar personat që do të kalonin kufirin, vendin ku prodhoheshin dokumentet e falsifikuara, mënyrën si realizohej transporti, pagesat dhe fiksimin e momentit të kalimit të kufirit përmes arrestimit të personave që do të tentonin një veprim të tillë... dhe, nëse nuk arrihej të kapej personi me dokumentet e falsifikuara dhe, nëse nuk sekuestrohet dokumentacioni i falsifikuar, nuk arrihet të provohet plotësisht as ekzistenca e faktit penal e jo më autorësia.

[...]

Gjatë hetimit nuk është bërë e mundur që të identifikohen personat që do të kalonin kufirin me dokumente të falsifikuara apo të sekuestrohen këto të fundit.

Vetëm përmbajtja e bisedave telefonike nuk mund të jetë provë për ngritjen e një akuze, në rastin e këtyre veprave penale. Prandaj, kryerja e përgjimeve kombinohet me veprime të tjera hetimore në terren, siç janë vëzhgimet në vende publike, që aplikohen për të bërë të mundur identifikimin e personave që do të pajisen me pasaporta, viza apo leje qëndrimi të falsifikuara, vendin e prodhimit të tyre dhe sekuestrimin e dokumenteve.

Pikërisht për shkak se nga ana jonë janë konstatuar vështirësi në drejtim të përdorimit efikas të metodave të posaçme të hetimit, për shkak të problemeve që përmenda më lart në lidhje me mungesën e kapaciteteve të policisë së shtetit, është vazhduar me kontrollin e banesës së shtetasit P.B.

Sendet e gjetura në banesë përforconin dyshimet për kryerjen prej tij të këtij aktiviteti të kundërligjshëm në vitet 2001 – 2002, por sërish nuk mund të ishin prova për të ngritur akuzë. Ato do të merrnin vlerë provuese në rast të identifikimit të personave që kishin kaluar kufirin me dokumente të falsifikuara dhe sekuestrimin e këtyre të fundit...

Për rrjedhojë, në momentin kur si përgjimet, ashtu edhe kontrolli apo vëzhgimet nuk dhanë rezultat, u vendos pushimi i procedimit penal.



*Në këtë rrjedhë logjike të shpjegimit të fakteve gjen përgjigje edhe pyetja e Komisionit në lidhje me mosmarrjen në pyetje të shtetasit P. B. Mungesa e provave konkrete në ngarkim të tij e bën veprimin hetimor të paefektshëm, ndërkohë që ekspozimi i mëtejshëm i fakteve në lidhje me hetimin që do të vinin si rrjedhojë e marrjes në pyetje, do të ndërlikonte hetimin e personave të tjerë, të cilët vazhdonin të kryenin biseda telefonike me interes për hetimin...*

*Nga bisedat që ata kanë kryer në vazhdimësi nuk rezultuan të dhëna në drejtim të bashkëpunimit të tyre me P. B apo me personat e tjerë të dyshuar, për të cilët ishte vendosur pushimi. Në rast se nga përgjimet e personave të tjerë do të dilnin në pah elemente që provonin bashkëpunimin e këtyre personave të tjerë me shtetasin P. B, atëherë nga ana e prokurorisë do vijohej me shfuqizimin e vendimit të pushimit dhe me vijimin e hetimeve, duke përfshirë shtetasin P. B.*

*Në përfundim vlerësoj se vendimi i pushimit të hetimit ka qenë i drejtë dhe ka ardhur në përfundim të kryerjes së veprimeve të mundshme hetimore, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat objektive në lidhje me mangësitë e theksuara të policisë për kryerjen e hetimeve të kësaj natyre në atë periudhë. Vendimet janë kontrolluar nga drejtuesit e prokurorisë dhe janë miratuar prej tyre.*

*Pavarësisht vullnetit të prokurorisë, hetimi proaktiv është një veprimtari e koordinuar mes organit të prokurorisë dhe policisë dhe rezultati kërkon angazhimin maksimal të të dyja palëve. Në rastin e procedimit nr. \*\*\* duket qartë që hetimi nuk ka arritur objektivin për shkaqe të pavarura nga prokurorët e që lidhen me mangësi të theksuara në punën e policisë. Nga ana e prokurorëve janë urdhëruar verifikime, përgjime, vëzhgime, kontrole, është administruar dokumentacion etj., veprime këto që lidhen me rolin e prokurorit në hetimin e një çështjeje penale.*

*Me shterimin e këtyre rrugëve për shkak të mungesës së rezultateve dhe të kapaciteteve të policisë për të qenë efektive në terren është vendosur pushimi i hetimeve.*

*Hetimet nuk mund të vazhdojnë pafundësisht për shkak të kufizimeve që vendos ligji procedural penal në raport me zgjatjen e tyre, ndërkohë që edhe mjetet në dispozicion janë të kufizuara. Në të gjitha këto raste, nëse hetimi nuk finalizohet me sekuestrimet e sendeve të ndaluara apo me identifikimin dhe me ndalimin e personave që kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme, është më se e logjikshme që hetimet të pushohen. Vetë ligji procedural penal në germën “dh”, të nenit 328.1, e parashikon një eventualitet të tillë, ku me gjithë dyshimet për kryerjen e veprave penale nuk arrihet të provohet se vepra penale është kryer nga i pandehuri.”*

#### ❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë të plota dhe bindëse. Pas vlerësimit të këtyre shpjegimeve, Komisioni arriti në konkluzionin se hetimi është zhvilluar logjikisht e ligjërisht në përmbushje me detyrimet e një prokurori në një procedim penal të një natyre proaktive. Subjekti, nëpërmjet shpjegimeve dhe analizës që i bëri të dhënave të përfutuara nga veprimtaria hetimore e kryer për këtë çështje, si edhe përshkrimin të llojit të marrëdhënieve mes prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në hetimet proaktive, i dha përgjigje çështjeve që Komisioni kishte ngritur dhe kishte përcjellë si problematika. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika në hetimin e kësaj çështjeje, të tilla që të tregonin për mangësi dhe për defekte thelbësore në veprimtarinë hetimore dhe vendimmarrëse të subjektit të rivlerësimit.

#### ➤ **TË DHËNAT ARKIVORE (Ankesat dhe masat disiplinore – vlerësimet)**

Në arkivën e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që subjekti Olsian Çela të ketë pasur ndonjë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve ndaj tij, të ketë pasur implikim të ndonjë vepre penale apo cenim të figurës së tij apo ndaj tij. Prokuroria e Përgjithshme, për vitet

2013, 2014, 2015 dhe 2016, e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, z. Olsian Çela, me “shumë mirë”.

Prokuroria e Përgjithshme, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2018, ka urdhëruar fillimin e procedimit disiplinor për prokurorin Olsian Çela. Kjo prokurori ka konfirmuar se ka vendosur mbylljen e hetimit disiplinor për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore dhe se materialet përkatëse *do të dërgohen në sekretarinë e Prokurorisë së Përgjithshme deri në zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Hetimi konsiderohet i përfunduar, por pavarësisht kësaj Prokurori i Përgjithshëm nuk e ka kompetencën të vendosë fillimin e procedimit disiplinor, çështja konsiderohet në proces deri në një vendimmarrje të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.*

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka përcjellë informacionin në Prokurorinë e Përgjithshme, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e kallëzuesit për veprën penale “shpifje për shkak të detyrës”, procedim i vitit 2008, ndaj të cilit Prokuroria Durrës ka vendosur pushimin e hetimeve të këtij procedimi.

Prokuroria e Rrethit Durrës ka përcjellë informacionin pranë Prokurorisë së Përgjithshme se ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Olsian Çela, si dhe ndaj disa subjekteve të tjera është bërë kallëzim nga shtetasi I. M., referuar veprës penale “shpërdorim detyre” dhe “kryerje e veprimeve arbitrare”. Kjo prokurori, në datën 16.7.2014 ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal” në lidhje me kallëzimin e paraqitur nga shtetasi I. M., me arsyen se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Vendimi i mosfillimit është ankimuar nga shtetasi I. M. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.12.2014, vendosi “rrezimin e kërkesës së shtetasit I. M. si të pabazuar”. Ky vendim nuk u ankimua nga ana e ankuesit në Gjykatën e Apelit Durrës.

#### ➤ DENONCIME NGA PUBLIKU

Ndaj subjektit e të rivlerësimit janë depozituar pesë denoncime nga publiku: (1) denoncimi i shtetases SH. I., i datës 12.12.2017; (2) denoncimi i shtetases R. B., i datës 1.2.2019; (3) denoncim i shtetasit M. M., i datës 4.3.2019; (4) denoncim i shtetasit A. M., i datës 11.4.2019; (5) denoncim i shtetasit V. Ç., i datës 5.4.2019.

Komisioni, pasi analizoi denoncimet e sipërpërmendura, konstaton se ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimi. Po ashtu, nga verifikimi i denoncimeve nuk u konstatuan indice për veprime korruptive apo kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit.

#### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

Trupi gjykues vlerëson se në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe të kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme, shfaq aftësi në arsyetim ligjor, respekton standardin e procesit të rregullt ligjor dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/a të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të

besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin të aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Olsian Çela.
  2. Vendimi i arsyetuar iu njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose nga Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim shpall në Tiranë, në datën 23.7.2019.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*

*P/Gledis Hajdini*